



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 12
Prishtinë, më 06 maj 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 06 MAJ 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 90 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Ratifikimi i Marrëveshjes për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, të 11 marsit 2011,
2. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNCTAD (Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin softueri ASYCUDA),
3. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastrë në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,
4. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe KfW-Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjetës Regional-Prishtina,
5. Ratifikimi i Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut,
6. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik

në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,

7. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, të mbështetur nga deputetë të tjerë,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2010,
10. Shqyrtimi i Raportit i punës të Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2010.

Kryetari, në fillim të mbledhjes i njoftoi deputetët se debati parlamentar për ratifikimin e gjashtë Marrëveshjeve mund të bëhet në tërësi, ndërsa votimi bëhet për secilën marrëveshje, veç e veç.

Ai në vazhdim ftoi Ministrin e Financave që të paraqesë dhe arsyetojë ratifikimin e marrëveshjeve.

Ministri **Bedri Hamza**, në fillim të fjalës së tij falënderoi të gjitha grupet parlamentare me të cilat gjatë diskutimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, kanë diskutuar edhe për këto marrëveshje, të cilat po shqyrtohen sot në Kuvend. Ai shprehu bindjen se ratifikimi i këtyre marrëveshjeve do të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të vendit, ndërsa më pas shpjegoi bazën ligjore të këtyre marrëveshjeve.

Ministri **Hamza** lidhur me pikën **e parë** të rendit të ditës – Marrëveshja për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, të 11 marsit 2011, theksoi se kjo Marrëveshje ofron mbështetje financiare për politikën që zbatohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Tregtisë e Industrisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Shuma totale e kthimit për dhjetë vite në emër të kësaj Marrëveshjeje do të jetë nën 38.000 €.

Lidhur me pikën **e dytë** të rendit të ditës – Marrëveshja në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNCTAD (Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin softueri ASYCUDA), ministri theksoi se ky program është instaluar në 96 vende të botës, Marrëveshja kap shumë prej 4,5 milion €, ndërsa Qeveria me mjete të veta do të investojë në trajnimin e stafit.

Lidhur me pikën **e tretë** të rendit të ditës - Marrëveshja për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, ministri vuri në pah stabilitetin që krijon kjo marrëveshje në tregun e pronave të paluajtshme në Kosovë, rritjen e sigurimit të pronës, eliminimin e mosmarrëveshjeve nga kjo fushë etj.

Lidhur me pikën **e katërt** të rendit të ditës – Marrëveshja në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe KfW- Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjellësit Regjional-Prishtina, ministri sqaroi se efektet e kësaj Marrëveshjeje qëndrojnë në mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujit të pijshëm të Ujësjellësit Regjional-Prishtina. Granti për këtë projekt kap shumë prej 11 milion €, ndërsa kthimi i mjeteve parashihet të bëhet nga viti 2020, me një normë të interesit prej 0.75%, konstatoi ministri.

Lidhur me pikën **e pestë** të rendit të ditës – Marrëveshja bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut, ministri theksoi se Marrëveshja ka të bëjë me përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm për regjionin e Mitrovicës, ndërsa shuma e përgjithshme e projektit kap shumën prej 4.7 milion €.

Lidhur me pikën **e gjashtë** të rendit të ditës – Marrëveshja për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, ministri potencoi se ky projekt do të zbatohet nga Ministria e Financave, do të përfshijë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Bujqësisë etj, ndërsa shuma e përgjithshme e projektit kap shumën prej 8 milion \$ dhe ndahet në dy pjesë. Në fund, ministri Hamza ftoi deputetët për miratim të këtyre marrëveshjeve.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ta paraqesë rekomandimin lidhur me këto marrëveshje.

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se komisioni që ajo kryeson ka shqyrtuar të gjitha marrëveshjet dhe ia kemi rekomanduar Kuvendit, për miratim. Ajo konstatoi se të gjithë anëtarët e komisionit kanë qenë pro miratimit të këtyre marrëveshjeve.

Në fund, deputetja Hadergjonaj ftoi deputetët për miratim të këtyre marrëveshjeve.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, deklaroi se do të votojnë pro ratifikimit të këtyre marrëveshjeve.

Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deklaroi se do të votojnë pro ratifikimit të pesë (5) Marrëveshjeve, ndërsa nuk do të votojnë Marrëveshjen në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe UNCTAD - Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin softueri ASYCUDA, për të cilën dha arsyetimin.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, deklaroi se do të votojnë pro ratifikimit të këtyre marrëveshjeve.

Ibrahim Makolli, në emër të Koalicionit Kosova e Re, deklaroi se do të votojnë pro ratifikimit të këtyre marrëveshjeve.

Sasha Rashiq, në emër të GP SLS, deklaroi se do të votojë pro ratifikimit të këtyre marrëveshjeve.

Duda Balje, në emër të GP “6+”, deklaroi se do të votojnë pro ratifikimit të këtyre marrëveshjeve.

Pasi nuk pati diskutues të tjerë, **Kryetari** hodhi në votim, një nga një, të gjitha Marrëveshjet.

Votimi për ratifikimin e Marrëveshjes për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, të 11 marsit 2011. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 102,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, të 11 marsit 2011.

Votimi për ratifikimin e Marrëveshjes në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNCTAD (Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin softueri ASYCUDA). Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 93,
Kundër----- 13,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNCTAD (Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin softueri ASYCUDA).

Votimi për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 105,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Votimi për ratifikimin e Marrëveshjes në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe KfW- Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjetës Regjional-Prishtina. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 105,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfW- Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjetës Regjional-Prishtina.

Votimi për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 104,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut.

Votimi për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 103,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

7. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, të mbështetur nga deputetë të tjerë

Kryetari Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se deputeti Nait Hasani dhe grupi i deputetëve nënshkrues ka parashtruar në Kuvend kërkesën për debat parlamentar për gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Ai i njoftoi deputetët se me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, Informata për këtë çështje kanë dërguar zv.kryeministri dhe ministri i drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, si dhe ministri i Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi.

Kryetari ftoi deputetin Nait Hasani që të bëjë prezantimin dhe arsyetimin e kërkesës për debat.

Nait Hasani tha se kërkesa e tij për debat vjen si rezultat i shumë çështjeve të pazgjidhura, të cilat i brengosin qytetarët e vendit. Mos respektimi i ligjeve nga EULEX-i i cili ka ardhur në Kosovë me ftesë të institucioneve të vendit, fatkeqësisht nuk ka përmbushur arritjen e objektivave për të cilat ka ardhur.

Deputeti Hasani, në vazhdim, konstatimin e lartpërmendur e ilustroi me shumë dukuri negative, veçanërisht në veri të vendit, siç janë: funksionimi i strukturave paralele të Serbisë, cenimi i sigurisë fizike të shqiptarëve në atë pjesë të vendit, shkelja e Kushtetutës së Kosovës etj.

Më tutje, ai përmendi arrestimin e paradokohshëm të disa ish pjesëtarëve të UÇK-së, të cilët luftuan për çlirimin e Kosovës, në mesin e të cilëve edhe komandantin rajonal të policisë në Prizren, ndërsa skenat e bastisjeve të EULEX-it në institucionet e Republikës së Kosovës i ngjajnë më shumë pamjeve të një puçi ushtarak, për të cilat tha se kanë rezultuar pa prova reale.

EULEX-i është shndërruar në një mekanizëm politiko-propagandistik dhe nuk është i interesuar të vendos rendin dhe ligjin në pikat doganore të Kosovës dhe lejon funksionimin e strukturave paralele serbe në Kosovë, konstatoi ai.

Deputeti Hasani, në fund të kësaj paraqitjeje i lexoi katër rekomandime për Kuvendin dhe i ftoi deputetët që t'i votojnë ato.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalë rasti paraqitën para deputetëve edhe ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi dhe ministri i Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi, të cilat janë pasqyruar në transkript.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Ibrahim Makolli, si dhe deputetët: Afërdita Berisha-Shaqiri, Arsim Bajrami, Haki Demolli, Behar Selimi, Donika Kadaj-Bujupi, Rexhep Selimi, Aurora Bakalli, Burim Ramadani, Fatmir Limaj, Vjosa Osmani, Time Kadrijaj, Sadri Ferati, Shaip Muja, Albin Kurti, Sali Asllanaj, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Anton Çuni, Fadil Demaku, Afrim Kasolli, Eqrem Kryeziu, Hasime Krasniqi, Liburn Aliu, Myzejene Selmani, Lutfi Haziri, Bekim Haxhiu, Sabri Hamiti, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ramë Vataj, Nazane Breca, Lirije Kajtazi, ministri Hajredin Kuçi dhe ministri Bajram Rexhepi, që janë dhënë në transkript.

Deputeti **Nait Hasani**, në fund të diskutimeve propozoi që një delegacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës të vizitojë Parlamentin Evropian dhe ta njoftojë atë mbi performancën e EULEX-it në Kosovë.

Kryetari hodhi në votim Rekomandimet e propozuara nga deputeti Hasani.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 32,
Kundër----- 15,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohen rekomandimet e deputetit Nait Hasani dhe të grupit të deputetëve nënshkrues, për gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, si në vijim:

1. Të vendoset kushtetutshmëria dhe sundimi i ligjit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës,
2. Kërkohet nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe misionet ndërkombëtare në Kosovë, që ta respektojnë Kushtetutën dhe ligjet në fuqi,
3. Kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare që në mënyrë urgjente të ndërmarrin hapa konkret në shpërndarjen e strukturave paralele të aparatit shtetëror të Serbisë në Kosovë,
4. Kërkohet nga Misioni Ndërkombëtar të bëjë implementimin e Planit të Pakos së Ahtisarit edhe në pjesën veriore të Kosovës.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund përkrahu Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010.

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, tha se komisioni që ajo drejton ka shqyrtuar Raportin financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar miratimin e tij në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha -Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, si dhe deputetët: Hashim Deshishku, Sala Berisha –Shala dhe Ardian Gjini, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 31,

Kundër----- 28,

Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010.

Në vazhdim të mbledhjes plenare, deputeti **Ardian Gjini** propozoi të shtyhet shqyrtimi i dy pikave të fundit të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi kërkoi nga Kuvendi të deklarohet për propozimin e deputetit Gjini.

Kuvendi miratoi propozimin për shtyrjen e dy pikave të fundit të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 18:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale